

LIGJ Nr.7703, datë 11.5.1993
PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Neni 6 Mbrojtja e detyrueshme

Sigurimet shoqërore mbrojnë në mënyrë të detyrueshme gjithë shtetasit ekonomikisht aktivë në Shqipëri, në rastin e pakësimit të të ardhurave si pasojë e barrë lindjes, pleqërisë, invaliditetit dhe humbjes së mbajtësit të familjes.

Sigurimet shoqërore, gjithashtu, i japin mbrojtje të detyrueshme gjithë personave të punësuar në rastin e pakësimit të të ardhurave si pasojë e paaftësisë së përkohshme të shkaktuar nga sëmundja, aksidenti në punë, sëmundja profesionale dhe papunësia. Këshilli i Ministrave mund të vendosë për fusha të tjera mbrojtjeje, si dhe për përjashtime për:

- a) Punëtorët sezonalë dhe të përkohshëm;
- b) të vetëpunësuarit në bujqësi;
- c) punëtorët e papaguar të familjes së personave të vetëpunësuar;
- ç) kursantët dhe studentët për kohën e praktikës mësimorë, të cilët sigurohen vetëm për aksidentin në punë nga punëdhënësit.

“d) pensionistët e vetëpunësuar, të cilët marrin pension dhe që ushtrojnë, të vetëm, veprimtari ekonomike profesionale, sipas nenit 9 të këtij ligji.”. (Shtuar me ligjin 144/2015 date 17.12.2015)

Neni 9 Llojet e kontributeve për t’u paguar

Personat e punësuar dhe punëdhënësit e tyre janë të detyruar të paguajnë kontribut për sëmundje, barrë lindje dhe pensione në një shumë që varet nga paga e tyre totale (bruto). Kontributi nuk mund të caktohet nën një pagë minimale dhe mbi një pagë maksimale mujore.

Punëdhënësit detyrohen të paguajnë kontribut për aksident në punë e sëmundje profesionale dhe për papunësinë.

Personat e tjerë ekonomikisht aktivë janë të detyruar të paguajnë kontribut mujor për barrë lindje dhe për pensione të llogaritura për një pagë jo më të vogël se paga minimale në shkallë vendi dhe jo më të lartë se paga maksimale kontributive.”.

Punonjësit e papaguar të familjes, që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin, paguajnë kontribut për barrë lindje dhe për pensione mbi bazën e pagës minimale në shkallë vendi.”.

“Për kategori të veçanta personash, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike profesionale, për- fshirë edhe punonjësit e papaguar të familjes që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin, profesionet, paga për efekt të llogaritjes së kontributeve, si dhe kriteret e përcaktimit të saj, nga paga minimale deri në nivelin e pagës maksimale, caktohen nga Këshilli i Ministrave.”.(Shtuar me ligjin 144/2015 date 17.12.2015)

Personat e vetëpunësuar në bujqësi janë të detyruar të paguajnë kontribut për barrë lindje dhe për pensione. Masat dhe kriteret caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Shteti paguan kontribute në varësi të veprimtarisë ekonomike të zhvilluar më parë për kohën që shtetasi kryen shërbimin e detyrueshëm ushtarak, si dhe për të

gjithë kategoritë e personave të përcaktuar me ligje dhe me vendime të Këshillit të Ministrave.